



Prishtinë, 11 nëntor 2014

Kodi i ZRRE-së: V_661_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 03/L-185);
- Nenin 17 dhe nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Njoftimin për ecurinë e punës së montimit të gjeneratorëve të Erës, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin "Bostan", KK Novobërdë, të datës 18.09.2014, të shoqërisë "Wind Power" SH.A., me adresë: Bulevardi i Dëshmorëve nr. 72/8B, Prishtinë, Republika e Kosovës

në seancën e mbajtur me datë 11 nëntor 2014 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **PËRFUNDON** afati i vlefshmërisë së Vendimit për Lëshimin e Autorizimit V-299-2010 të datës 11 nëntor 2010 për ndërtimin e gjeneratorëve me Erë, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin "Bostan", KK Novobërdë.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 03.03.2009 nga ndërmarrja Wind Power SH.A, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin "Bostan", zona kadastrave, KK Novobërdë.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era, me datë 22 shtator 2009 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_205_2009, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o ZRRE me datë 29.07.2010 ka pranuar Kërkesën për shndërrimin e Njoftimit mbi Vendimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin "Bostan" KK Novobërdë.
- o ZRRE me datë 11 nëntor 2010 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin final V-299-2010 për ndërtimin e gjeneratorëve me Erë, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin "Bostan", KK Novobërdë.



- Me Vendimin për Autorizim Final është autorizuar shoqëria “Wind Power” SH.A., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e lartë cekuar, sipas kushteve dhe afate të përcaktuara me Autorizim.
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit është lëshuar në afatin dy (2) vjeçar, duke filluar nga data e lëshimit të tij, ku ka sqaruar se me kërkesë të palës, mund të vazhdohet vlefshmëria e autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ZRRE me datë 16.04.2014 nga shoqëria “Wind Power” SH.A. ka pranuar kërkesën për shtyrjen e afatit për instalimin e gjeneratorëve të erës që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë, edhe për një periudhë gjashtë (6) mujore, gjegjësisht deri me 15 tetor 2014.
- Në kërkesën për shtyrje të afatit për instalimin e gjeneratorëve të erës, shoqëria “Wind Power” SH.A., ka arsyetuar se për shkak të vështirësive të mëdha financiare nuk kanë arritur t’i instalojnë gjeneratorët në lokacionet e lartcekura, të përcaktuar në bazë të Autorizimit, pasi që, për një kohë të gjatë nuk është arritur marrëveshja me “KEK” SH.A, gjegjësisht “KEDS” SH.A., rreth nënshkrimit të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë. Pas arritjes së Marrëveshjes për Blere të Energjisë me “KEDS” SH.A. në bazë të tarifës së rregulluar për gjeneratorët e erës të instaluar në Golesh, Wind Power SH.A., ka rishfaq interesimin për vazhdimin e instalimit të turbinave të erës në Bostan, KK Novobërdë.
- Në arsyetimin e saj, aplikuesi sqaron se bazamentet e turbinave dhe të gjitha përgatitjet për montimin dhe instalimin e gjeneratorëve në fjalë janë të kryera, ku i posedon të gjitha lejet e nevojshme, kushtet teknike janë realizuar duke filluar nga ndërtimi i bazamenteve shtrirja (trasimi) e kablllove për kyçje, ndërtimi i trafo dhe i kthinës, montimi i njehsorit matë etj. Poashtu edhe gjeneratorët janë të transportuar në vendin e ngjarjes, ku vetë duhet të montohen dhe instalohen.
- Gjithashtu ka sqaruar se montimi i gjeneratorëve të erës është specifik sepse duhen vinça të mëdhenj, e që montimin duhet me realizuar vetëm një kompani nga Maqedonia, ku duhet kohë për afërsisht 3-4 muaj të bëhen parapërgatitje. Poashtu edhe kushtet atmosferike ndikojnë në montimin e gjeneratorëve.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 29 prill 2014 ka obliguar shoqërinë “Wind Power” SH.A., që deri me **15 tetor 2014** të përfundojë instalimin e gjeneratorëve me Erë, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet total prej 900kW, në lokacionin “Bostan”, KK Novobërdë, të lejuar me Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V-299-2010 të datës 11 nëntor 2010, dhe ka njoftuar aplikuesin se pas kalimit të afatit për instalimin e gjeneratorëve të erës, të përcaktuar me këtë vendim, Vendimi V_299_2010 i datës 11 nëntor 2010 mbi Vendimin Lëshimin e Autorizimit, **do të shfuqizohet**.
- ZRRE me datë 18.09.2014 ka pranuar njoftimin për ecurinë e punës së montimit të gjeneratorëve të erës, ku aplikuesi ka cekuar se janë bërë të gjitha përgatitjet për montimin dhe instalimin e gjeneratorëve të erës, dhe kan kontaktuar kompanitë në Maqedoni që merren me instalimin dhe montimin e gjeneratorëve me erë, si dhe ka sqaruar se brenda afatit të përcaktuar në vendimin e fundit, do të bëni vendosjen dhe funksionalizimin e tyre.



- ZRRE pas kësaj date të cekuar më lartë nuk ka pranuar asnjë dëshmi në lidhje me vendosjen dhe funksionalizimin e gjeneratorëve me erë sipas vendimit në fjalë, ka vlerësuar se kanë përfunduar afatet ligjore dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


II. Me këtë vendim, shfuqizohet V_299_2010 të datës 11 nëntor 2010.


III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare,


Krenar Bujupi, anëtar.